

analiza buxhetore

e sektorit të kulturës në Komunitat Perëndimore
të Kosovës (2018-2021)

Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë Dhe Pejë

CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO



Ky botim është financuar nga Qeveria e Suedisë përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA). Përmbytja e këtij materiali nuk mund të merret parasysh për të pasqyruar pikëpamjet e SIDA-s.



Maj 2019

Redaktorë: Adea Mekuli,

Erinë Mulolli Zajmi

Hulumtues: Donikë Limani, Kujtim Koci,


Lorëz Qehaja

Botimi: Fondacioni Kosovar

Trashëgimia Kulturore Pa Kufij

(CHWB Kosova)

Dizajni: Trembelat



analiza buxhetore

e sektorit të kulturës në Komunitat Perëndimore
të Kosovës (2018-2021)
Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë Dhe Pejë



Përmbajtja

Hyrje —9

Analiza e Buxheteve Komunale —11

Të dhënat e përmbledhura —11

Të gjeturat nga analiza e KAB-eve komunale —17

Komuna e Deçanit —19

Komuna e Gjakovës —20

Komuna e Junikut —23

Komuna e Istogut —24

Komuna e Klinës —27

Komuna e Pejës —28

Përfundime —31

Shtojcë: Ligjet dhe praktikat në lidhje me buxhetet komunale —37

Përmbajta ligjore —38

Ligjet në praktikë —40

Lista e figurave

Figura 1: Buxhetet për Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si përqindje e buxheteve totale komunale —12

Figura 2: Të punësuarit në Drejtoritë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si përqindje e stafit total komunal —14

Figura 3: Nëndarja e shpenzimeve të Drejtorive të Kulturës, Rinisë dhe Sportit —16

Lista e tabelave

Tabela 1: Shpenzimet komunale —12

Tabela 2: Shpenzimet kapitale për Komunën e Deçanit (2019-2021) —18

Tabela 3: Shpenzimet kapitale për Komunën e Gjakovës (2019-2021) —20

Tabela 4: Shpenzimet kapitale për Komunën e Junikut (2018-2020) —22


Tabela 5: Shpenzimet kapitale për Komunën e Istogut (2018-2020) —24

Tabela 6: Shpenzimet kapitale për Komunën e Klinës (2019-2021) —26

Tabela 7: Shpenzimet kapitale për Komunën e Pejës (2019-2021) —27

Tabela 8: Krahasimi i buxheteve komunale në bazë të popullatës —31

Tabela 9: Të punësuarit në Komunitet e Rajonit Perëndimor —32



hyrje

Ky dokument përmban një analizë të shpenzimeve komunale për sektorin e kulturës, rinisë, sportit dhe rekreacionit për vitet 2018-2021 në komunat perëndimore të Kosovës: Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë dhe Pejë. Drejtoria përgjegjëse për këto fusha është ajo e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Prandaj, analiza e paraqitur më poshtë, në çdonjërin prej komunave përqendrohet në këtë drejtori. Të dhëna më të detajuara ekzistojnë për 2018, ndërsa për vitin 2019, 2020, 2021 janë përdorur vetëm parashikimet për shpenzimet totale (dhe jo nëndarje).

Pjesa e parë të kësaj analize përmban disa të dhëna të përmbladhura për të gjashtë komunat. Ndërsa, pjesa e dytë përmban prioritetet strategjike të komunave në sektorin e kulturës dhe rekreacionit. Këto informata janë marrë kryesisht nga Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) e secilës komunë.

Analiza e Buxheteve Komunale

Të dhënat e përmbledhura

Komuna e Pejës dhe e Gjakovës janë komunat me buxhetet më të mëdha ndër komunat e listuara. Rrjedhimisht buxhetet e përcaktuara për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vitin 2018 janë më të lartat në këto dy komuna, € 786,191 në Pejë dhe € 635,307 në Gjakovë. Tabela 1 më poshtë përmban këto informata më hollësisht për secilën komunë dhe për vitet 2018-2020.

Tabela 1: Shpenzimet komunale

Komuna	2018		2019		2020	
	Total	DKRS	Total	DKRS	Total	DKRS
Deçan	€ 8,517,397	€ 103,411	€ 9,218,454	€ 123,806	€ 9,957,958	€ 114,224
Gjakovë	€ 3,266,603	€ 635,307	€ 5,094,029	€ 690,013	€ 27,040,369	€ 720,751
Istog	€ 10,197,776	€ 336,932	€ 10,994,018	€ 283,174	€ 11,856,357	€ 255,000
Junik	€ 1,730,462	€ 36,505*	€ 1,826,795	€ 38,6521	€ 1,627,205	€ 28,8011
Klinë	€ 9,694,954	€ 143,937	€ 10,433,883	€ 154,846	€ 11,220,553	€ 154,924
Pejë	€ 24,554,896	€ 786,191	€ 26,468,681	€ 771,811	€ 28,513,985	€ 1,280,703

* Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Junikut funksionon bashkë me Arsim. Mirëpo, për dallim prej fushës së Arsimit në këtë drejtori, e cila e ka kodin e vet buxhetor, një kod të tillë nuk e ka edhe Kultura, Rinia dhe Sporti. Rrjedhimisht, buxheti i DKRS-së në Junik, paraqet vetëm buxhetin e fushës së Arsimit.

Në figurën 1 më poshtë mund të shohim buxhetet për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si përqindje e buxhetit total. Në asnjërin prej komunave kjo drejtori nuk merr më shumë se 4 përqind të buxhetit total komunal. Peja, jo vetëm që është një ndër komunat me buxhetin më të madh për këtë drejtori, por ajo gjithashtu shpenzon relativisht më së shumti ndër këto komuna. Për më tepër, komuna e Pejës parasheh një rritje të dukshme të buxhetit për pjesën e dedikuar ndaj Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit nga 3.2 përqind të buxhetit total në 2018 në 4.5 përqind në 2019. Komuna e Gjakovës, edhe pse me buxhet komunal ngjashëm të madh me komunën e Pe-

jës, shpenzon dukshëm më pak për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit se kjo e fundit dhe parasheh zbritje të përqindje së dedikuar për këtë drejtori në vitin 2020. Komuna e Deçanit është komuna që shpenzon pjesën më të vogël të buxhetit për Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit. Për më tepër, pritet që në 2020 shpenzimet për këtë drejtori të përbëjnë vetëm 1.1 përqind të buxhetit total komunal. Komuna e Istogut gjithashtu parasheh zbritje të dukshme të buxhetit për këtë drejtori. Nga 3.3 përqind të buxhetit komunal në vitin 2018, komuna e Istogut planifikon të shpenzojë vetëm 2.2 përqind të buxhetit të vitit 2020 për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Komuna e Junikut ka probleme në planifikim afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiviteteve dhe investimeve në sektorin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në saje të mungesës së kodit të veçantë buxhetor në këtë fushë. Për t'i zbatuar planet dhe aktivitete e tyre, shpenzimet mbulohen nga linja të tjera buxhetore brenda komunës.




Figura 1: Buxhetet për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si përqindje e buxheteve totale komunale.

Komuna e Pejës ka gjithsej 50 të punësuar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe gjithashtu paraqet 2 përqind të tërë stafit të komunës.

Në figurën 2 më poshtë mund të shohim të punësuarit në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në gjashtë komunat e përfshira në këtë analizë. Komuna e Junikut ka numrin më të vogël të të punësuarve (4) në këtë drejtori nga të gjitha komunat. Mirëpo, kur marrim parasysh numrin e të punësuarve nga komuna në total, Juniku ka përqindjen më të madhe të stafit në këtë drejtori (3%) krahasuar me komunat e tjera. Komuna e Pejës ka gjithsej 50 të punësuar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe gjithashtu paraqet 2 përqind të tërë stafit të komunës. Komuna e dytë me më së shumti të punësuar në këtë drejtori është ajo e Gjakovës me 33 të punësuar, të cilët përbëjnë vetëm 1 për qind të stafit të komunës. Komuna e Istogut ka përqindjen më të vogël të punësuarve në këtë drejtori, 8 të punësuar që përbën 0.8 për qind të stafit total komunal.




Figura 2: Të punësuarit në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, si përqindje e stafit total komunal.

Në figurën 3 më poshtë janë disagreguar shpenzimet e Drejtorisë të Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2018 në kategoritë: Pagat dhe Mëditje, Mallëra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere si dhe Shpenzime Kapitale. Një pjesë e madhe e buxhetit të kësaj drejtorie shkon drejt pagave dhe mëditjeve. Komuna që ka shpenzuar më së shumti në këtë kategori në vlerë absolute është ajo e Pejës, më saktësisht € 286,191 në 2018. Mirëpo, komuna e Junikut dhe Deçanit shpenzojnë pjesën më të madhe të buxhetit në këtë kategori. Pagat dhe mëditjet përbëjnë rreth 76 dhe 93 për qind të buxheteve të drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në Komunën e Deçanit dhe Junikut respektivisht.

Mallrat dhe Shërbimet përbëjnë një pjesë më të vogël të buxhetit të kësaj drejtorie në të gjashtë komunat pjesë e këtij raporti. Në Junik, vetëm € 2,700 janë shpenzuar në këtë kategori nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më pak se 10 për qind e buxhetit të saj. Komunat me më së shumti shpenzime në mallra dhe shërbime janë ajo e Pejës dhe Gjakovës, me €160,000 (20% e buxhetit të drejtorisë) dhe €147,000 (23% e buxhetit të drejtorisë) e buxhetit të drejtorisë e buxhetit të drejtorisë respektivisht.

Shpenzimet komunale janë pjesë e buxhetit të kësaj drejtorie vetëm në komunën e Pejës dhe atë të Gjakovës me €70,000 (9% e buxhetit të drejtorisë) dhe €56,000 (9% e buxhetit të drejtorisë) respektivisht. Komuna e Gjakovës ka shpenzuar më së shumti nga gjashtë komunat në subvencione dhe transfere €121,482 (19% e buxhetit të drejtorisë), ndërsa në komunën e Deçanit dhe Junikut nuk është shpenzuar asnjë shumë parash në këtë kategori.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale, komuna e Istogut, edhe pse ndër komunat me buxhet më të vogël, dallohet nga gjashtë komunat e tjera me shumën më të lartë absolute dhe relative të shpenzuar në këtë kategori. Në vitin 2018, në Istog janë bërë shpenzime kapitale në vlerë të €233,758 nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe kjo shifër paraqet 69 për qind të buxhetit të kësaj drejto-

rie. Komuna e Pejës dhe e Gjakovës kanë shpenzuar më tepër se 20 përqind të buxhetit të kësaj drejtorie në shpenzime kapitale, €170,000 dhe €128,000 respektivisht. Ndërsa komuna e Klinës dhe ajo e Junikut¹ nuk kanë ndërmarrë asnjë shpenzim kapital në vitin 2018.





Figura 3: Nëndarja e shpenzimeve të Drejtorive të Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

¹ Në Komunën e Junikut, Kultura, Rinia dhe Sporti nuk kanë kod buxhetor.



të gjeturat nga analiza e
KAB-eve komunale

Komuna e Deçanit

Korniza afatmesme buxhetore (KAB) e komunës së Deçanit përban një analizë të hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës për periudhën 2019-2021. Ky dokument shërben si një mekanizëm i dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuara në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit. Në të shpalosen vizione, objektivat dhe indikatorët kyç të komunës për vitet në vijim. Komuna e Deçanit ka përcaktuar këto katër objektiva për vitet 2019-2021:

1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë
2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve
3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dh qëndrueshmëria e tij
4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Gjatë vitit 2018, rreth 300 të rinj janë angazhuar në aktivitete kulturore, ndërsa në vitin 2019, 2020 dhe 2021 priten të marrin pjesë më tutje edhe rreth 400, 500 dhe 500 të rinj respektivisht.

Tek objektivi i dytë i komunës, një ndër nën-objektivat e komunës ka të bëjë me projektet për rini, kulturë dhe ofrimi i terreneve të reja sportive. Gjatë vitit 2018, rreth 300 të rinj janë angazhuar në aktivitete kulturore, ndërsa në vitin 2019, 2020 dhe 2021 priten të marrin pjesë më tutje edhe rreth 400, 500 dhe 500 të rinj respektivisht. Për sa i përket anës financiare, për këto projekte rinore e kulturore, komuna e Deçanit ka shpenzuar €25,000 në vitin 2018 dhe planifikon të shpenzojë nga €30,000 për secilin vit në periudhën 2019-2021. Gjithashtu, në KAB-in e komunës së Deçanit janë paraqarë të shpenzohen €10,000 në vit për vitin 2020 dhe 2021 me qëllim renovimin e objekteve kulturore.

Tabela 2: Shpenzimet kapitale për Komunën e Deçanit (2019-2021)

Shpenzimet kapitale	2019	2020	2021
Shuma në total	€ 150,000	€ 10,000	€ 10,000
Ndërtimi i qendrës rinore	€ 150,000		
Renovimi i objekteve kulturore	-	€ 10,000	€ 10,000

Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës në KAB-in e saj ka përcaktuar si mision të qeverisë: “[...] përshpejtimin e ritmeve të zhvillimit ekonomik, shtimin e mundësive për shkollim, avancim të llojit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore, kulturën, rininë dhe sportin, lëminë e bujqësisë si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të mjedisit dhe infrastrukturës komunale si çështje më kryesore që mund të ndikojnë për përmirësimin e shpejtë të gjendjes ekonomike e shoqërore të banorëve të Komunës”.

Më saktësisht, prioritetet dhe objektivat e komunës së Gjakovës për periudhën 2019-2021 janë këto:

1. Rritja dhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik
2. Qeverisja e mirë dhe fuqizim i sundimit të ligjit;
3. Zhvillimi i resurseve njerëzore;
4. Rritja e standardit jetësor dhe e mirëqenies sociale për banorët e Komunës së Gjakovës.

Ndër detajet e objektivave të lartpërmendura, njëri me rëndësi për sektorin e kulturës dhe rekreacionit është ai që synon të zhvillojë dhe avancojë sektorin e NVM-ve dhe turizmit në Gjakovë si dhe nën-objektivi për ruajtjen dhe kultivimin e traditës kulturore dhe asaj sportive në funksion të promovimit dhe zhvillimit të turizmit të Gjakovës. Nëse fokusohemi specifikisht te Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, komuna e Gjakovës ka si vizion të ketë rezultate në arritjen e një



kulturë të avancuar dhe moderne, rini të shëndoshë, gjithëpërfshirëse dhe me perspektivë në të gjitha lëmitë. Si pjesë e qëllimeve të kësaj drejtorie është edhe vetëdijesimi i përgjithshëm për ruajtje dhe prezantim të vlerave tradicionale.

Për vitet në vijim parashihen të ndërmerren një sërë shpenzimesh kapitale në kulturë. Këto shpenzime kapitale janë planifikuar nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik si dhe ajo për Kulturë, Rini dhe Sport. Në total, ato kapin shumën €453,000 për vitin 2019, €338,000 në 2020 dhe €260,000 në 2021. Këto investime kapitale janë të ndryshme dhe përfshijnë renovime të objekteve kulturore, sportive, etj. Lista e detajuar e projekteve të planifikuara është si më poshtë:

Tabela 3: Shpenzimet kapitale për Komunën e Gjakovës (2019-2021)

Shpenzimet kapitale	2019	2020	2021
Shuma në total	€ 453,000	€ 338,000	€260,000
“Pejzash i Mbrojtur Shkugëza”	€ 35,000		
Zhvillimi i pikës turistike ne Lumin Erenik	€ 60,000	€ 35,000	
Revitalizimi i Urës se Terezive: Ndryçimi gjelbërim, shtigje të ecjes etj.	€ 25,000		
Ura e Fshajtë & Kanioni, ndryçimi, shtegu për ecje	€ 70,000	€ 50,000	€ 35,000
Shpella e Kusarit, ndryçimi, rruga, shenjëzimi	€ 35,000		
Roller Zip Line	€ 35,000	€ 25,000	
Shtigje në Pemë	€ 30,000	€ 30,000	
Funksionalizimi i Çarshisë së Madhe		€ 10,000	€ 10,000
Renovimi i Pallatit të Kulturës	€ 20,000	€ 22,000	€ 25,000
Biblioteka “Ibrahim Rugova”	€ 6,000	€ 7,000	€ 8,000
Renovimi i Muzeut Etnografik	€ 10,000	€ 5,000	
Muzeu i familjes Qerkezi	€ 5,000		
Renovimi i pallatit të kulturës / Cërmjan	€ 10,000		
Stadiumi i Qytetit (Futboll)		€ 60,000	€ 70,000
Revitalizimi i "Eshnores" - Qabrat	€ 80,000	€ 60,000	€ 50,000
Rrethimi i K.F.Dushkaja	€ 10,000		
Pajisja me reflektorë led, Palestra Shani Nushi	€ 10,000		
Renovimi i terreneve sportive		€ 1,000	€ 47,000
Punimet në Galerinë e Arteve		€ 10,000	
Revitalizimi i Qendrave Rinore	€ 12,000	€ 13,000	€ 15,000

Komuna e Junikut

KAB-i për komunën e Junikut për periudhën 2018–2020 ka prezantuar këto objektiva:

1. Zhvillimin, promovimin dhe rigjenerimin e infrastrukturës lokale
2. Përmirësimin e ambientit për të jetuar
3. Përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit të komunitetit
4. Zhvillimin e sferës së shëndetësisë, arsimit, kulturës dhe sportit
5. Ofrimin e mjeteve për nevojtarët dhe të dëmtuarit
6. Përkrahjen dhe zhvillimin e bizneseve dhe aftësive individuale të talenteve

Në komunën e Junikut, drejtorja për Arsim dhe ajo për Kulturë, Rini dhe Sport funksionojnë si një departament. Misioni specifik i kësaj drejtorie për sa i përket Kulturës, është të menaxhojë, udhëheqë dhe kryejë të gjitha punët përkitazi me lëminë e kulturës në Komunë. Gjithashtu, ajo ka si mision organizimin e punës dhe aktiviteteve me rininë në të gjitha fushat, si dhe organizimin e jetës sportive e sigurimitin e kushteve për zhvillimin e sportit. Drejtorja e zhvillimit ekonomik ka gjithashtu pjesë të misionit të saj krijimin e mundësive për zhvillim të turizmit si pikë kyçe të Komunës për zhvillim më të madh ekonomik.

Shpenzimet kapitale të kësaj komune që ndërlidhen me fushën e kulturës janë ndërmarrë nga Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik si dhe fonde nga linja të tjera buxhetore. Gjatë vitit 2018 janë shpenzuar rreth €870,000 në projekte të kësaj fushe. Ndërsa, për vitin 2019 dhe 2020 janë planifikuar të ndërmerren projekte të këtij lloji në shumë prej €485,000 dhe €1,590,000, respektivisht. Tabela më poshtë ofron një listë më të hollësishme të këtyre projekteve.



Tabela 4: Shpenzimet kapitale për Komunën e Junikut (2018-2020)

Shpenzimet kapitale	2018	2019	2020
Shuma në total	€ 870,000	€ 485,000	€ 1,590,000
Hapja, Gjurmimi dhe Vënia në funksion e vendbanimit të periudhës së bronzit për vizitorët "Gropa e Amonit"	€ 390,000		
Restaurimi dhe vënia në funksion e monumenteve të vjetra si: Kullat, Mullinjtë dhe Valavicat	€ 300,000		
Hapja dhe sinjalizimi i shtigjeve të reja	€ 30,000		
Hapja e shtegut malorë për Bicikleta	€ 20,000	€ 20,000	
Hapja dhe trasimi i rrugëve malore	€ 100,000	€ 110,000	
Organizimi I festivalit "Ditët e Gështenjës"	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000
Organizimi I festivalit "Zhdjergat"	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000
Organizimi I festivalit "Ditët e Kullave"	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000
Krijimi I identitetit vizuel-turistik "Juniku"		€ 180,000	
Mbrojtja dhe ndërtimi I monumentit natyrorë "Kroi I madh"		€ 15,000	
Ndërtimi I qendrës kulturore-historike-tradicionale-Junikase		€ 70,000	€ 60,000
Ndërtimi I pallatit të kulturës			€ 1,500,000
Ndërtimi i shtëpizës malore-turistike-bjeshkatore në Bjeshkë		€ 60,000	

Komuna e Istogut

KAB-i i Komunës së Istogut për periudhën kohore 2018-2020 paraqet këtë vizion për të ardhmen e kësaj komune: “Zhvillim Ekonomik me prioritet sektorin e Agroturizmit dhe Bujqësisë, Urbanizëm modern dhe Shërbime Publike Efikase, një Qendër e Kulturës dhe Turizmit të pasur, Arsimim cilësor, Shërbime Shëndetësore adekuate, Rini të shëndoshë dhe me aktivitete Sportive”. Më saktësisht këto janë objektivat e Komunës për këtë periudhë kohore:



1. Zhvillimi Ekonomik Lokal përmes sektorëve: Bujqësisë, Turizmit, Agroturizmit, Përpunimit të Prodhimeve Bujqësore, Ndërmarrjeve të Vogla (Bizneset Familjare) dhe Ndërmarrjeve të Mesme.
2. Avancimi i infrastrukturës turistike, mjedisit dhe resurseve, ndërtimi i shtigjeve për ecje dhe vrapim, promovimi i kulturës ekologjike të Istogut.
3. Krijimi i kushteve për arsim cilësor duke u bazuar në trendin e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë për nxënësit para fillor, fillor dhe të mesëm. Mirëmbajtja dhe rregullimi i ndërtesave të arsimit me kushtet e efijencës së energjisë.
4. Krijimi i kushteve për shërbime shëndetësore cilësore dhe preventivat për zvogëlimin e sëmundjeve të rënda dhe të lehta, në nivelin e shëndetësisë primare.
5. Krijimi i kushteve për një Administratë Komunale për shërbim efijent për qytetar me theks të veçantë në hap me zhvillimin e teknologjinë informative.
6. Rregullimi i infrastrukturës Publike (Asfaltimi, Rregullimi, Mirëmbajtja verore dhe dimërore të rrugëve lokale, ujësjellësi, kanalizime, rregullimi i hapësirave publike, rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave, mirëmbajtja dhe rregullimi i tregjeve, mirëmbajtja dhe ndriçimi i hapësirave publike me kushtet e efijencës së energjisë, etj.
7. Sigurimi i kapaciteteve funksionale infrastrukurore fizike dhe promovimi i aktiviteteve rinore, kulturore dhe arsimore.

Shpenzimet kapitale të kësaj komune që ndërlidhen me fushën e kulturës janë ndërmarrë nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Gjatë vitit 2018 janë shpenzuar rreth €132,500 në projekte..ndërsa, për vitin 2019 dhe 2020 janë planifikuar të ndërmerren projekte të këtij lloji në shumë prej €315,500 dhe €726,796, respektivisht. Tabela më poshtë ofron një listë më të hollësishme të këtyre projekteve.

Tabela 5: Shpenzimet kapitale për Komunën e Istogut (2018-2020)

Shpenzimet kapitale	2018	2019	2020
Shuma në total	€ 132,500	€ 15,500	€ 726,796
Studimi i fizibilitetit për zonën Turistike	€ 25,000	€ 25,000	€ 25,000
Ndërtimi i pistës për paragllajd			€ 25,000
Ndërtimi dhe shënjzimi i shtegut për Hiking "Refugjati" në Kaliqan			
Renovimi i sallës së koncerteve ulëseve dhe dyshemesë	€ 30,000	€ 60,000	
Participim në restaurimin e objekteve të trashëgimisë Kulturore	€ 10,000	€ 50,000	
Mbledhja e artefakteve dhe eksponateve për muze	€ 10,000		
Veshje kombëtare për nxënës për të gjitha shkollat	€ 8,000		
Festivali i valleve popullore	€ 1,000	€ 5,000	€ 7,796
Botimi i librit me poezi për nxënës të shkollave	€ 1,000	€ 1,000	€ 1,000
Festivali kombëtare Istogu këndon		€ 10,000	€ 10,000
Instalimi i ngrohjes qendrore në sallën e kulturës faza e II			
Varjete Pranverore	€ 4,000		
Zbulimi i talenteve të rinjë	€ 3,500		
Festivali gurra e folklorit shqiptare			
Festivali i fëmijëve	€ 3,000		€ 3,000
Festa e ushqimeve tradicionale	€ 3,000		€ 3,000
Mirë se erdhët mërgimtare			
Ndërtimi i Amfiteatrit Veror prapa shtëpisë së kulturës		€ 70,000	
Ndërtimi i shtëpisë së kulturës në Gurrakoc		€ 65,500	€ 115,000
Krijimi i teatrit amator të qytetit		€ 3,000	€ 3,000
Karnavali i qytetit në Istogut	€ 10,000	€ 10,000	€ 10,000
Dekorimi i qytetit me drita vezulluese	€ 5,000	€ 5,000	€ 5,000
Organizimi I turnirit me moton e kujtojmë Fadil Feratin	€ 3,000	€ 3,000	€ 3,000
Java e Rinise	€ 8,000	€ 8,000	€ 8,000
Lojërat popullore tradicionale - pa kufi -	€ 3,000		€ 3,000
Kamping Rinor -Rugove	€ 5,000		€ 5,000
Ndërtimi i zonës Turistike Mokna			€ 500,000

Komuna e Klinës

KAB-i i Komunës së Klinës është përgatitur për periudhën 2019-2021. Vizioni i kësaj komune është që Klina të bëhet një vend ekonomikisht i zhvilluar, me një administratë komunale efikase në shërbim të qytetarëve dhe bizneseve, mjedis të pastër dhe atraktiv për të jetuar dhe investuar. Më specifikisht, prioritet do t'i jepet zhvillimit të NVM-ve, bujqësisë, turizmit, dhe infrastrukturës fizike si dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, shëndetësi dhe shërbime publike. Objektivat e komunës së Klinës për periudhën kohore 2019-2021 janë këto:

1. Zhvillimi ekonomik
2. Zhvillimi i infrastrukturës së nevojshme në funksion të qytetarëve dhe bizneseve
3. Përmirësimi i cilësisë së arsimit dhe shëndetësisë
4. Përparimi dhe mbrojtja e mjedisit jetësor
5. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve

Si nën-objektiv i objektivit të parë të Komunës së Klinës është paraparë edhe zhvillimi i turizmit dhe trashëgimisë kulturore. Tre indikatorë janë hartuar për të matur përbushjen e këtij objektivit. Indikatorë i parë është rritja e sipërfaqjeve të pyllëzuara dhe hapësirave të gjelbëruara, ku vlera bazë (2018) është 10 përqind e sipërfaqes së komunës. Për vitin 2019 ata presin një rritje prej 15%, 20% në 2020 dhe 25% në 2021. Indikatorë i dytë është rritja e numrit të vizitorëve për 25% në 2019, 35% në 2020 dhe 45% në 2021. Indikatorë i tretë është rritja e mirëqenies së ekonomive familjare për 20% në 2019, 15% në 2020 dhe 20% në 2021. Për sa i përket anës financiare për përbushjen e këtij nën objektivit, Komuna e Klinës ka ndarë €80,000 në 2019,

€100,000 në 2020 dhe €150,000 në 2021. KAB-i i Komunës së Klinës nuk përmban plan të hollësishëm për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në këtë periudhë kohore. Gjithsesi, sa i përket investimeve kapitale, Komuna e Klinës ka ndarë €70,000 për Kulturë në 2020 dhe të njëjtën shumë për vitin 2021.

Tabela 6: Shpenzimet kapitale për Komunën e Klinës (2019-2021)

Shpenzimet kapitale	2019	2020	2021
Shuma në total	€ 60,000	€ 70,000	€ 70,000
Ndërtimi i fushës ndihmese të futbollit (sportit)	€ 40,000		
Rregullimi i oborrit të kullës së Mujë Krasniqit	€ 15,000		
Renovimi i shtëpisë së kulturës	€ 5,000		
Ndërtimi i muzeut dhe i galerisë së qytetit – faza e parë		€ 70,000	
Ndërtimi i muzeut dhe i galerisë së qytetit – faza e dytë			€ 70,000

Komuna e Pejës

KAB-i i komunës për periudhën kohore 2019-2021 parasheh si vizioni të komunës një qytet të zhvilluar drejt turizmit, urbanizmit modern dhe shërbimeve efikase e kualitative, një qendër e kulturës dhe arsimit, jetës sportive dhe shërbimeve financiare të zhvilluara. Më saktësisht, pesë prioritet e komunës për periudhën afatmesme janë këto:


1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë
2. Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve
3. Përmirësimi i ambientit të Komunës dhe qëndrueshmëria e tij
4. Të bëhet Komuna vend më i sigurtë dhe i drejtë/fer për qytetarët e saj
5. Ofrimi i shërbime efikase që u përgjigjen kërkesave të qytetarëve



Disa ndër objektivate specifike të prioritetit të parë të komunës së Pejës janë zhvillimi i turizmit, ndërtimi i Resortit turistik Teleferikut dhe dhënia e mbështetjes së veçantë për turizmin dhe hotelierinë në edukimin e kuadrove profesionale Gjithashtu, te prioriteti i dytë i komunës, një ndër objektivat është promovimi i projekteve për rini, sport dhe kulturë. Sipas KAB-it, komuna e Pejës planifikon të shpenzojë rreth €167,000 në 2019, €200,000 në 2020 dhe €200,000 në 2021 për shpenzime kapitale që mund të ndërlidhen me fushën e kulturës. Tabela më poshtë i liston këto projekte.

Tabela 7: Shpenzimet kapitale për Komunën e Pejës (2019-2021)

Shpenzimet kapitale	2019	2020	2021
Shuma në total	€167,000	€200,000	€200,000
Ndërtimi i Murit Mbrojtës dhe Tribunave pranë Fushave të Tenisit në Karagaç.	€40,000		
Ndërtimi i Zhveshtoreve dhe Hapësirës për Mbajtjen e Garave Ndërkombëtare të Tenisit në Brestovik	€40,000		
Blerja dhe Montimi i Ulëseve në Fushën e Basketit "Valon Begolli" si dhe Stadiumin në Brestovik	€12,000		
Renovimi i Teatrit	€20,000		
Blerja e pianos për Teatër	€40,000		
Ndërrimi i Dyerve në hyrjen e Tribunave Perëndimore dhe Veriore si dhe Rregullimi i Çatisë në Palestrën Karagaç.	€15,000		
Ndërtimi i fushave sportive në qytet		€200,000	€200,000



përfundime

Në këtë dokument kemi paraqitur një analizë të shpenzimeve komunale për fushën e kultuës për vitet 2018/9-2020/1 në këto komuna të Kosovës: Deçan, Gjakovë, Istog, Junik, Klinë dhe Pejë. Jemi fokusuar kryesisht te Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Më poshtë janë paraqitur të gjeturat e analizës të përgjithshme të buxheteve komunale.

1 Buxhetet e përcaktuara për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në vitin 2018 janë më të lartat në Pejë (€ 786,191) dhe Gjakovë (€ 635,307).

2 Komuna e Pejës parasheh një rritje të dukshme të buxhetit për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

3 Komuna e Deçanit është komuna që shpenzon pjesën më të vogël të buxhetit për Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe pritet që në 2020 shpenzimet për këtë drejtori të përbëjnë vetëm 1.1 për qind të buxhetit total komunal.

4 Komuna e Pejës ka gjithsej 50 të punësuar në Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që paraqet 2 përqind të stafit të komunës në përgjithësi.

5 Komuna e Istogut ka përqindjen më të vogël të punësuarve në këtë drejtori, 8 të punësuar që përbën 0.8 përqind të stafit total komunal.

6 Komuna e Istogut dallohet nga gjashtë komunat e tjera me shumën më të lartë absolute dhe relative drejt shpenzimeve kapitale.

7 Komuna e Klinës nuk ka ndërmarrë asnjë shpenzim kapital në vitin 2018.

8 Në Komunën e Junikut, Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit funksionon bashkë me Arsimin. Mirëpo, për dallim prej sektorit të Arsimit i cili ka të ndarë kodin e vet buxhetor, sektori i Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk kanë kod të caktuar buxhetor.

Tabelat e në faqen në vijim paraqesin krahasimin në mes të komunave sa i përket shpenzimeve të komunës në aktivitete kulturore si përqindje e shpenzimeve të tjera, numri i personave të punësuar në DKRS si përqindje e numrit total të personave të punësuar në komunë, dhe shpenzimet e komunave për kulturë, rini dhe sport për kokë banori.

- **Komuna e Istogut** shpenzon më së shumti për kulturë, rini dhe sport nga të gjitha komunat në krahasim me popullatën. Në vitin 2018, ajo ka shpenzuar rreth 9 euro për kokë banori për kulturë, rini dhe sport, që paraqet 3.3 përqind të buxhetit komunal të atij viti për kokë banori.
- **Në të kundërt, komuna e Deçanit** shpenzoi më së pakti për këtë sektor, te rreth 3 euro për kokë banori që është vetëm 1.2 përqind e buxhetit të vitit 2018 për kokë banori të kësaj komune.


Tabela 8: Krahasimi i buxheteve komunale në bazë të popullatës

Komuna	Popullata 2011	Buxheti komunal 2018	Buxheti DKRS 2018	Buxheti komunal 2018 për kokë banori	Buxheti DKRS 2018 për kokë banori	Buxheti DKRS si % e buxhetit gjithsej
Deçan	40,019	€ 8,517,397	€ 103,411	€ 213	€ 3	1.2%
Gjakovë	94,556	€ 23,266,603	€ 635,307	€ 246	€ 7	2.7%
Istog	39,289	€ 10,197,776	€ 336,932	€ 260	€ 9	3.3%
Junik	6,084	€ 1,730,462	€ 36,505	€ 284	€ 6	2.1%
Klinë	38,496	€ 9,694,954	€ 143,937	€ 252	€ 4	1.5%
Pejë	96,450	€ 24,554,896	€ 786,191	€ 255	€ 8	3.2%

Tabela 9: Të punësuarit në Komunat e Rajonit Perëndimor

Komuna	Deçan	Gjakovë	Istog	Junik	Klinë	Pejë
Numri i të punësuarve në Komunë 2018	875	2,232	969	163	944	2,225
Numri i të punësuarve në DKRS 2018	13	33	8	5	14	50
Përqindja e të punësuarve në DKRS 2018	1.5%	1.5%	0.8%	3.1%	1.5%	2.2%

Me të dhënat në dispozicion, nuk mund të ofrohet rekomandim konkret për shpenzimet e komunës për sektorin kreativ dhe aktivitetet kulturore. Kjo për arsye se për këto lloj të rekomandimeve nevojiten të dhëna edhe për shpenzimet e komunës në projekte, sektorë dhe aktivitete të tjera. Për më shumë, nevojitet të merret një krahinë tjetër krahasuese, me specifika të përafërta të rajonit dhe komunave që janë pjesë e këtij studimi, që të shfrytëzohet si mjet krahasues për të parë nëse investimet e tanishme të komunës në sektorin publik janë të mjaftueshme apo jo.



shtojcë: ligjet dhe
praktikat në lidhje me
buxhetet komunale

Përmbajta ligjore

Buxheti komunal rregullohet me anë të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal². Në këtë ligj sqarohet se komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK), të cilat përbëhen nga: Grantet e Përgjithshme, Grantet Specifike për Arsim dhe Grantet Specifike për Shëndetësi. Shuma e Grantit të Përgjithshëm është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore, duke përfshirë: të hyrat nga shitja e pasurive, të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, të hyrat e dedikuara, dhe të hyrat nga huamarrja. Për më tepër, në këtë ligj përmendet se me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunave më të vogla, nga totali i Grantit të Përgjithshëm, secila komunë pranon një shumë të përgjithshme prej 140,000 € në vit, minus 1€ për kokë banori, ose 0€ për komunat me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000. Pjesa e mbetur e Grantit të Përgjithshëm u alokohet komunave në përpjesëtim me: numrin e popullsinë, numrin e popullsisë pakicë, nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakica kombëtare; dhe madhësia gjeografike. Më saktësisht, popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); numri i popullsisë pakicë me tre për qind (3%); komunat, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%); dhe përmasat gjeografike me gjashtë për qind (6%).

Granti Specifik për Arsim përcaktohet dhe u alokohet komunave në përputhje me formulën e përcaktuar nga Komisioni i Granteve. Kjo formulë bazohet në numrin e regjistruar të nxënësve dhe standardet të siguruara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe në numrin e normalizuar të mësimit dhe regjistrimit. Sipas ligjit, formula gjithashtu merr parasysh programin mësimor kombëtar, arsimin për nevojat të veçanta, shpenzimet operative që nuk përfshijnë

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 27 / 03 qershor 2008 Ligji Nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2525>

pagat, normat e madhësisë së klasave dhe lokacioni. Në këtë ligj përmendet se nxënësve minoritar I kushtohet rëndësi e veçantë. Granti Specifik për Shëndetësi përcaktohet dhe i alokohet komunave në bazë të popullsisë së normalizuar dhe standardet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Normalizimi merr parasysh moshën dhe strukturën gjinore të popullsisë së regjistruar të ofruesit e shëndetësisë primare si dhe numrin e personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta shëndetësore.

Ligji për Vetëqeverisjen Lokale është ndër bazat e vendimarrjes në komunë, të cilat ndër të tjerash kanë të bëjnë edhe me alokimin e buxhetit për projekte të caktuara³. Neni 68 i këtij ligji e bën obligative mbajtjen periodike të takimeve publike nga komuna, së paku dy herë në vit. Në këto takime publike mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë, dhe përfaqësuesit komunal informojnë pjesëmarrësit për aktivitetet e komunës. Pjesëmarrësit mund të shtrojnë pyetje dhe të japin propozime për përfaqësuesit e zgjedhur komunal. Përveç takimeve publike të cekura më artë, komunat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës.

Për sa i përket pjesëmarrjes së donatorëve në financim, nga hulumtimi i dokumenteve publike komunale nuk na rezulton një rregullore specifike për këtë çështje. Megjithatë, neni 10 i Ligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2019 flet mbi ndarjen e granteve të donatorëve⁴. Ai rregullon që të gjitha grantet e donatorëve depozitohen në Fondin e Kosovës dhe regjistrohen në SIMFK, përveç nëse kërkohet ndryshe nga donatori dhe nëse ka një pajtim me shkrim nga ana e Ministrit. Pas kompleti-

³ Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës / Prishtinë: Viti III / Nr. 28 / 04 qershor 2008 Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale <https://gzk.rks-gov.net/actdetail.aspx?actid=2530>

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 4 / 14 shkurt 2019, Prishtinë Ligji Nr. 06/L -133 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4CEFBA4C-4397-4901-AB93-2AA37F43A9F7.pdf>

mit të procedurave sipas Rregullave Financiare të Thesarit, grantet e donatorëve ndahen për qëllimet e specifikuara, dhe mund të alokohen dhe të shpenzohen vetëm për ato qëllime. Kur marrëveshja për grantin e donatorit kërkon shprehimisht që donatori të bëjë kompensimin e shpenzimeve të caktuara që shkaktohen nga organizata buxhetore, shuma e plotë e grantit ndahet pas ekzekutimit të marrëveshjes së grantit. Neni 14 i këtij ligji fokusohet më specifikisht në fondet e donatorëve për pushtetin lokal. Ai cek se fondet e ndara për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për projektin : “Bashkëfinancim me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancë komunale”, rialokohen në projekte kapitale pas aprovimit të Qeverisë në përputhje me marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshkruar në mes të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, Kryetarit të Komunës përkatëse dhe Donatorit.

Ligjet në praktikë

Për të kuptuar se si ndodh në praktikë përcaktimi dhe financimi i projekteve / investimeve kapitale nga gjashtë komunat në fokus, ne kemi hulumtuar publikimet, raportet dhe lajmet komunale. Nga ky hulumtim na rezulton se edhe pse përfshirja e qytetarëve dhe palëve të interesit është e rregulluar me ligj, nuk ka platformë të mirëfilltë e konsistente ndër komuna për të parë se sa janë marrë parasysh nevojat dhe interesat e qytetarëve apo palëve të interesit. Në të gjashtë komunat mund të gjinden lajme në web-faqet zyrtare që tregojnë sipërfaqësisht mbajtjen e dëgjimeve publike kryesisht për buxhetin.

Komuna e Pejës është ndër komunat më transparente nga të gjashta, pasi që procesverbalet e këtyre takimeve me publikun mund të gjenden në faqen e komunës⁵. Ajo gjithashtu ka një grup specifik për DKRS-në që është tejet aktiv në rrjetet sociale dhe informon publikun për punën dhe planet e kësaj drejtorie. Komuna e Istogut

⁵ Shiko lidhësen: <https://kk.rks-gov.net/peje/category/procesverbalet-e-degjimeve-buxhetore/?page=2018>

i përmend shkurtimisht takimet publike për planifikimin e buxhetit për vitin 2019-2020 në Raportin e Punës të Kuvendit Komunal⁶. Komuna e Klinës gjithashtu ka ndërmarrë hapa konkret për përfshirjen e publikut në vendimet për investime kapitale dhe ka angazhuar OJQ Koha të mbikëqyrë punën e Komunës në këtë aspekt. Raporti i OJQ-së Koha shpjegon detajisht hapat e ndërmarrë në bashkëpunim me Komunën e Klinës për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të tjera të interesit në hartimin e politikave publike Komunale⁷. Disa nga shembujt e përmendur janë audio-reklamat, themelimi i grupeve lokale dhe takimeve të shpeshta të këtyre grupeve me përfaqësuesit e ekzekutivit dhe legjislativit të Kuvendit Komunal të Klinës, etj. Për sa i përket komunave të tjera që janë në fokus të këtij studimi, informatat për këto takime publike janë kryesisht në formë të lajmeve të postuara në faqet e internetit të komunës përkatëse.

Për sa i përket procedurës në praktikë të pjesëmarrjes dhe financimit nga donatorët në projektet komunale janë, të gjeturat e hulumtimit tregojnë se nuk ekzistojnë informata publike të përmbledhura mbi këtë çështje. Në fjalë të tjera, nuk është e qartë për publikun e cilat projekte kanë nevojë për financim nga donatorët, si vendosin donatorët të marrin pjesë në këto projekte. Informatë tjetër e dobishme do të ishte nëse komunat janë proaktive në raport me donatorët, domethënë nëse ato kontaktojnë vetë donatorët për projektet që duan të realizojnë apo nëse ato presin vetëm qasjen nga vetë donatorët.

⁶ Komuna e Istogut (2018). Raporti i Punës së Kuvendit Komunal për Vitin 2018. (<https://kk.rks-gov.net/istog/wp-content/uploads/sites/13/2019/02/Raporti-i-punes-se-KK-se-2018.pdf>)
⁷ Krasniqi, L. et al (2017). Pjesëmarrja e Publikut në Vendimmarrje në Komunën e Klinës 2016 – 2017, OJQ KOHA (<https://ojq-koha.org/wp-content/uploads/2018/03/Pjes%C3%ABmarrja-e-publikut-n%C3%AB-vendimmarrje-n%C3%AB-Komun%C3%ABn-e-Klin%C3%ABs.pdf>)



CH
WB
Cultural
Heritage without Borders
KOSOVO